

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HENE 14 SHTATOR 2023

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Jam sot këtu për të përshëndetur qeverinë e Malit të Zi dhe Kryeministrin Abazoviç, që hapën dje, në një akt drejtësie, shkollën e parë shqipe në Rozhajë, në një zonë e cila ka qenë djep i shqiptarizmit, banorët e së cilës, në kushte tejet të vështira, arritën të ruajnë gjuhën dhe identitetin e tyre. Kështu që unë përshëndes qeverinë, ministrin e Arsimit dhe ministrin tjetër, nëse nuk gabohem, të çështjeve të pakicave, të cilët inauguruan shkollën e parë shqipe në Rozhajë. Kjo marrëveshje, që sillni e recitoni këtu, pa diskutim është një akt i dobishëm për një numër punëtorësh, të cilët detyrohen të largohen sot në republikën fqinje, për shkak të rrogave thuajse dy herë më të larta krahasuar me vendin e tyre, ndonëse resurset ekonomike të Malit të Zi janë, së paku, 2-3 herë më të pakta se të Shqipërisë, por çdo fjalë dhe çdo përpjekje juaja për pensionistët është kulmi i hipokrizisë. Ju votuat këtu rritjen e rrogave të deputetëve me 3 milionë e 800 mijë lekë. Pra, ju e autorizuat deputetin të marrë nga mundi dhe nga djersa e qytetarëve shqiptarë aq sa marrin në muaj 38 pensionistë. Nuk ekzistojnë në botë raporte të tilla të shproporcionuara në sektorin publik, sepse ekziston kudo ai që quhet “kohezion social”, i cili i detyron qeveritë të ruajnë proporcione të pranueshme. Por, në një akt ekstrem cinizmi dhe korrupsioni për të blerë Gjykatën Kushtetuese, e cila sot sillet ndaj së drejtës kushtetuese si një organ që e shkelmon atë, aq sa është shkelmuar nga ajo gjykatë në 30 vjet të marrë së bashku, ju sot, në një akt absurd, në një akt të hapur korruptiv, kërkonti të rrisni 7 dhe 8 milionë rrogat e tyre. Unë po ju rikujtoj këtu se gjykatësi më i fuqishëm i botës, që është gjykatësi i Gjykatës Supreme të SHBA-ve, (Gjykata Supreme e SHBA-ve ka në spektrin e saj të shqyrtimit edhe çështjet kushtetuese), presidenti i kësaj gjykate, ka një rrogë vjetore 290 mijë dollarë.

Në vitin 2023, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka një rrogë vjetore 400 mijë dollarë, kurse ju përcaktoni një rrogë, për të blerë një tufë gjykatësish, pothuaj sa dyfishi i rrogës së Presidentit të Republikës, për të treguar se nuk njihni as hierarki shtetërore, as shtet, por vetëm interesa pazaresh dhe mafieje. Po si mund të jeni dakord dhe të flisni për pensionistët, kur i jepni një gjykatësi, që nuk ka qenë kurrë gjykatës, aq sa do të marrin 80 pensionistë në muaj?! Çfarë është ky akt?! Pse kaloni në këtë shkallë pashpirtësie ekstreme?! Pazaret dhe vetëm pazaret janë kriteret tuaja dhe të Edi Ramës. Ju jeni vetëm figurina të tij. Nuk ka parlament të një vendi demokratik në botë, i cili i lejon vetes këtë që bëni ju, të flisni për pensionistët këtu dhe të votoni rroga 10 herë më të mëdha se rroga mesatare, rroga 15 herë më të mëdha se rroga mesatare. Po ju jeni narkoshtet! Ju udhëhiqeni nga normat e një narkoshteti, e një mafiozi. Zonja Kryetare, Ky Parlament ka një rregullore dhe shkelësja më madhore e Rregullores është kryetarja e Parlamentit. Të garantoj që je duke kryer një akt të rëndë antiligjor, në çdo shkelje që bën. Nuk ka sallë parlamenti në botë, përveç Koresë së Veriut, ku deputetit t’i hiqet e drejta e procedurës. Edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Asamblenë e Përgjithshme, ku shumica që ulen aty nuk janë në demokraci, edhe aty “point of order”, pra “kërkesa për procedurë” është e detyrueshme sa herë që kërkohet. Je e vetmja kryetare parlamenti, e vetmja në 32 vjet, që u mohon deputetëve të drejtën e procedurës. E vetmja! Je e vetmja kryetare parlamenti që u mohon deputetëve të drejtën e shpjegimit të votës. Ti përfiton nga një rrethanë e tillë: nëse opozita do të merrej me ty, do të lehtësonte “padronin” tënd dhe, në këtë kontekst, ajo do të bënte një veprim jorentabël, sepse ti zbaton verbërisht vetëm urdhrat e Edi Ramës, por në këtë mënyrë ti e bën parlamentin një institucion mafioz, disfunksional.

Të gjithë ministrat kalojnë këtu, por kush fshihet? Më thoni! Pse i fshihni ju ata nga qytetarët?! Pse nuk lejoni të bëhen diskutime për ta? Sepse ata janë hajdutë, sepse ju jeni hajdutë! Nuk ka arsye tjetër, vetëm hajduti fshihet. Po të mos ishin të tillë, ata do të ishin krenarë, qoftë edhe ndaj sulmeve absurde. Ju nuk e nxirrni dot këtu Maznikun, sepse Mazniku ka firmosur me Flavio Tosin në “Eco Tirana”, ka firmosur me Emilio Ranzin, me bosin e Ndranghetës në Veneto, sepse Mazniku, nuk është si të gjithë ju këtu, sepse për një pjesë të mirë nuk mund ta them. Mazniku ka marrë 12 rroga, a e dini ju apo jo?! Ai bëhet ministër, se ka pasur fuqi të paguajë, të blejë, të bëjë pazare me Edi Ramën, ashtu si ajo tjetra, Koçiu, me regjistrime. Po si ka mundësi të zgjidhen vetëm ata që vjedhin?! Është një gjë jo e zakonshme për gratë dhe vajzat shqiptare. Absolutisht, jo e zakonshme! Edi Rama i zgjedh me kokrra. Po, po! Nga e gjeti këtë Albanën?! Ku është kjo, Koçiu?! Ja pra, këtu prapa është edhe kjo. Pse nuk bëhen diskutime, ku t’u thuhet qytetarëve se çfarë përfaqësojnë?! Të ngrihen të kundërshtojnë këtu, në qoftë se akuzohen me të padrejtë! Nuk e bëni, se jeni të gjithë hajdutë! Kriteri kryesor në qeveri është hajdutëria! Meqenëse po shkruan, do t’i them dy fjalë kësaj Elisës. Elisa, ke përdorur një term jo shumë të fisshëm, por unë nuk do të merrem me këtë, sepse e kuptoj që ti kërkon të bie në vulgaritet, por unë nuk bie. Unë jam mjek dhe ata që janë mjekë në këtë sallë e dinë se Zigmund Frojdi në klasifikimin e zhvillimit psiko-seksual ka gjetur se ky zhvillim te qeniet njerëzore kalon në pesë stade. Stadi i tretë, Elisa, është stadi falik, jo fatal, falik. Stadin falik, i cili shfaqet në moshën 3 deri në 5 vjeç, shumica e njerëzve e kalojnë si një stad që është për t’u kaluar. Disa mbeten dhe disave iu krijohet kompleksi i Edipit, i cili është i njohur tek Edi Rama.

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HENE 14 SHTATOR 2023

Zonja deputete,

Zotërinj mbatharakë që braktisni seancën, ju jeni deputetë që keni frikë nga vetja juaj, prandaj nuk rrini në seancë.

Rrogat për veten tuaj i dyfishuat, pastaj ia mbathni nëpër mejhane dhe kazino. Së pari, dua ta falënderoj Bankën e Këshillit të Europës për të gjithë angazhimin dhe projektet e saj në Shqipëri, të cilat janë dëshmi e një interesi të veçantë të këtij institucioni dhe të Këshillit të Europës për t'i ndihmuar Shqipërinë dhe shqiptarët për zgjidhjen e problemeve madhore sociale, shëndetësore dhe arsimore, që janë të natyrshme! Sot unë dua ta informoj Bankën e Këshillit të Europës, bordin e guvernatorëve të saj, se Shqipëria është vrima e zezë e fondeve të saj dhe se investimet e kësaj banke, jashtëzakonisht të dobishme dhe nevralgjike për ndërtimin e spitaleve dhe për pajisjen e tyre me aparaturat më moderne të sistemit të mjekësisë, u shpërdoruan si në asnjë vend tjetër të Europës, duke bërë që ministri Beqaj të krijojë sipërmarrjen e tij private. Të dashur qytetarë dhe qytetare, ajo që quhet vjedhja e dytë e shekullit i ka rrënjët në përvetësimin e Ilir Beqajt, si ministër, të një investimi jashtëzakonisht të rëndësishëm: ndërtimit të spitalit të urgjencës dhe diagnozës. Ai bashkë me "muratorin" Rrapaj, ka përvetësuar një kat të plotë dhe një aparaturë ultramoderne të sterilizimit për sipërmarrjen e tij, të blerë me kredinë e kësaj banke 1 milion e 700 mijë euro. Po kaq dramatik është fakti se, me kontratën e firmosur nga Ilir Beqaj për rreth 100 milionë euro për 10 vjet, ndërkohë për 5 vjet janë shpenzuar për t'i paguar kompanisë së tij 76 milionë euro. Pra, kontrata e sterilizimit u shoqërua me faljen nga Ilir Beqaj, për kompaninë e tij, të impiantit ultramodern të sterilizimit të një kati të tërë të spitalit të ri, të ndërtuar me fondet e Bankës së Këshillit të Europës. Ilir Beqaj, i amnistuar në mënyrën më të papërgjegjshme nga "SKAP"-i i partisë me urdhër të Edi Ramës, është personi që përzgjodhi "Byrazerin", kushëririn e tij të parë me mbiemër Byrazeri, për të bërë studimin e leverdishmërisë. Ilir Beqaj, me kushëririn e tij Byrazeri, deklaruan se koncesioni do ta ulte me katër herë çmimin e sterilizimit, në krahasim me atë që bëhej në shtet. KLSH-ja dhe auditet e pavarura kanë provuar se çmimi i sterilizimeve, i krahasuar me atë që ishte para koncesionit, u rrit me 80 herë. Ishte Ilir Beqaj, dhe jo vetëm ai. Ku është kjo ministria Manastirliu? Zonjë, ku janë këto ministret? Ulsi, hiqe atë tabelë dhe shkruaje aty "Eliza Fali", sepse emri im i saj i ri, nga sot e tutje, do të jetë "Eliza Fali" dhe jo "Pali", siç kujton ti. Pra, u rrit 4 herë më shumë se në Gjermani, për të vjedhur Ilir Beqaj bashkë me "Byrazerin" e tij. Vetëm për promovime dhe testime, nga 40 mijë euro që kanë shpenzuar, ka deklaruar se janë shpenzuar 6 milionë euro. Për të vjedhur me setet, ka deklaruar 400 milionë lekë të shpenzuara për operacion, të cilat janë abuzuar duke i shpallur lindjet normale me ndërhyrje cezariene që nuk janë bërë asnjëherë. Pra, kjo është një seancë në të cilën ju duhet t'i dënoni këto problematika, sikundër edhe dy problemet e tjera madhore, me të cilat do ta mbyll fjalën time. Prokuroria "Felaj" e Tiranës, me një akt kriminal të pashembullt, shpalli "plagosje të lehtë" çarjen e kockës frontale dhe parietale dhe thyerjen e ulnës të një qytetari nga fisi Rraja. Kjo është direkt një ndërhyrje e Edi Ramës dhe e Taulant Ballës; është një akt kriminal. Dënoj me forcën më të madhe megamashttrimin publik të sotëm që Rrumbullaku, në sqetullën e Ramës, u thotë shqiptarëve se u arrestuan 200 trafikantë në një ditë. I kërkoj këtu nga Parlamenti, të nxjerrë emrat, ose seancën tjetër do të quhet 200 herë gënjeshtar. Të nxjerrë emrat e të arrestuarve, të nxjerrë grupet, se thotë: "23 grupe"! Pra, e kuptoni ju propagandën Rama-Balla të mashtrimit dhe të mbulimit të krimit me shifra të rreme.

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HENE 14 SHTATOR 2023

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Prej një jave kupola e organizatës kriminale në qeverinë shqiptare i fsheh publikut shqiptar një operacion spektakolar të autoriteteve ligjvënëse spanjolle, të cilat identifikuan dhe arrestuan në Dubai, mikun e ngushtë deri në ortakëri të Olsi Ramës, Amant Josifin. Amant Josifi është një hajdut i paimagjinueshëm, i cili nëpërmjet call center-ve ka plaçkitur pensionistë dhe qytetarë spanjollë, gjermanë dhe të vendeve të tjera, në shumën totale rreth 2, 2 miliardë euro. Si ndodhi kjo?! Amant Josifi ishte këshilltari i Olta Xhaçkës (ku është kjo?!) dhe djali i nëpunëses së parë civile të shtetit, Strakosha. Po, djali i saj! Por Amant Josifi, më shumë sesa me Oltën dhe Strakoshën, kishte lidhje të fuqishme me vetë Olsi Ramën. Çfarë ndodhte, që ta dinë qytetarët?! Në qoftë se call center-at e tjera sulmoheshin ditë e natë nga tatimorët, nga policitë e ndryshme, kishte një call center që zmadhohej çdo javë. Punonjësve të call center-ve u thuhej të vinin të punonin tek ata, se ata kishin mbrojtje politike, se mbrojtja e tyre ishte Olsi Rama, Edi Rama, faktikisht. Në këtë rast del që arrestimi i tij në Dubai mbahet një javë i fshehtë nga Taulant Balla dhe Edi Rama. Sot duhet të ndalemi këtu për të thënë me forcë të madhe që pronari i ABC-së bashkë me lëpirësin Balla kanë pushuar nga puna, kanë larguar nga detyra njërin nga gazetarët më të shquar në fushën e investigimit, zotin Ferdinand Dervishi. Në qoftë se ne pranojmë që gazetarë, të cilët me hetimet e tyre japin një kontribut të madh për interesin publik, të flaken si leckë, ky Parlament nuk meriton të jetë më. Ferdinand Dervishi, me kompetencë të plotë, me guxim dhe përgjegjësi kërkoi hetimin e Taulant Ballës për plaçkitjen që i bënte nëpërmjet Ervin Muçës, databazës së TIMS-it. Ferdinand Dervishi, me një analizë logjike, duke iu referuar fakteve, nxjerr se mbrapa këtij akti kriminal qëndronte direkt pala shqiptare, qëndronte Taulant Balla.

Për këtë sistem, i cili ka një rëndësi nevralgjike në fushën e sigurisë dhe luftës së krimit, ka pasur një shqetësim të madh dhe një ndërhyrje të ligjshme nga përfaqësues të ambasadës së SHBA-ve. Dervishi konstaton se Balla dhe Rama dhanë të njëjtën përgjigje, duke mashtruar se nuk ka ndodhur dhe se hetimi është bërë. Tani Ferdinand Dervishin e pushoi nga puna pronari, që herë shfaqet e herë zhduket, por e garantoj se nuk do të mundet as të shfaqet, as të zhduket, dhe nuk do të mundet kurrë t'i flakë gazetarët si leckë. Me Edi Ramën lëvize si të duash akcizën e birrës, se edhe ai është një krim, por me fjalën e lirë dhe me gazetarët nuk mund të luash këtu, i them atij pronarit të ABC-së. Ndaj, shpreh solidaritetin tim të plotë me Ferdinand Dervishin. U bëj thirrje gazetarëve në Shqipëri dhe në botë të qëndrojnë në mbështetje të tij, sepse ai me shkrimin që bëri, duke kërkuar direkt hetimin e Taulant Ballës, rrezikoi veten dhe humbi vendin e punës për shkak të banditëve në pushtet. Zonja dhe zotërinj, I mbështes plotësisht të gjitha shkëmbimet me Republikën e Sllovakisë dhe uroj që ato të njohin zhvillime të reja pozitive. Natyrisht, marrëveshjet me Shqipërinë janë thjesht në letër, sepse nuk njihen dhe nuk respektohen. Së fundi, kur të shkosh në punë në Prokurorinë e Tiranës, atëherë përgjigju. Këtu je Zëvendëskryetare e Parlamentit. Nuk je as kryetare e Prokurorisë "Felaj" të Tiranës dhe as nënkryetare e saj. Ta them edhe një herë, nuk ka në botë një prokurori me 4 anëtarë familje, përveçse po të jenë grup privat detektivësh, dhe nuk mund të ndodhë ndryshe që të shpallet "plagosje e lehtë" thyerja e kockës frontale, e kockës panjetale dhe e ulnës me shkopinj bejsbolli nga klani mafioz "Raja"; por në të vërtetë është klani mafioz "Rama-Basha", më falni, Rama-Balla...

(Ndërhyrje pa mikrofon) Edhe ai me ata është, por nuk prish punë. A nuk dole ti dhe e bëre zëdhënës? A, po, është Linda?! A nuk i lexove ti komunikatat e tij? Pra, në këtë kontekst, ai është një akt i shëmtuar dhe të takon ty, si deputete, pavarësisht nga konflikti i interesit, ta dënosh atë me ashpërsinë më të madhe.

Faleminderit!